

RELACION

Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e tretë të vitit 2011

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr.10355, datë 02.12.2010 dhe Udhezimit nr.4 datë 27.01.2011 "Per buxhetin e shtetit për vitin 2011", i është akorduar një fond i planifikuar prej **91 milione e 840 mijë lekë**, i cili përbehet nga:

Fondi i Pagave:	10,985,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	2,000,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	7,015,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	69,840,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,868,000 Lekë (zeri 231)
Fondi per Investimet e Pa Trupezuara:	132,000 Lekë (zeri 230)

Fondi fillestar i miratuar nga Ministria e Financave ka pesuar disa ndryshime, si me poshte:

Fondi per Investimet e Trupezuara ka qene 2,000,000 Lekë (zeri 231), por eshte ndryshuar me kerkese te AMSHC, duke e pakesuar kete fond me shumen prej 132,000 Leke, e cila eshte transferuar per rritjen e zerit 230.

Fondi per Pagat ka qene 10,600,000 Lekë (zeri 600), por eshte ndryshuar me kerkese te AMSHC, duke e pakesuar kete fond me shumen prej 15,000 Leke duke e transferuar shume per rritjen e Fondit per Shpenzime Operative (zeri 602). Gjithashtu po ky fond eshte shtuar me shumen prej 400,000 Lekesh me kerkese te AMSHC ne peridhen Nentor 2011. Fondi i per transfertat ndaj te treteve (604) eshte pakesuar per efekt shkurtimelesh buxhetore ne shumen prej 3,500,000 Lekesh ne periudhen Shtator 2011.

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në 23,039,033 leke nga totali prej 23.039.033 Leke ose **24.69%**, të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË

PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”.

Gjatë 3- mujorit të dytë të vitit 2011, numri mesatar i punonjësve është realizuar 13 vete, nga 12 vete të miratuar.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

2,481,214 Lekë (zeri 600) për paga, realizimi **23.16%**.

400,704 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqerore, realizimi **20.04%**.

(Duke qene se ky ze ne muaj te ndryshem ka qene i ndryshem, per te nxjerre realizimin e tremujorit eshte nxjerre realizimet mujore dhe jane mbledhur)

Fondi per shpenzime në zeriin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), për vitin 2011, është planifikuar në vlerën 7,015,000 leke. Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **547,630 Lekë** ose **7.8%** e planit vjetor.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike falas për publikun, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevojat e AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të treta, të mbartura nga 2010.

Fondi në zeriin për Transferime Korrente të Brendshme (zeri 604), për vitin 2011 është planifikuar në vlerën 69,840,000 leke. Ky është dhe zeri me më shumë në strukturën e buxhetit të AMSHC, duke qene se dhe vete misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqerisë Civile me Grante për projektpropozimet të OJF përfituese.

Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **18,886,269 Lekë** ose **26.44%**, e planit vjetor. (Duke qene se ky ze ne muaj te ndryshem ka qene i ndryshem, per te nxjerre realizimin e tremujorit eshte nxjerre realizimet mujore dhe jane mbledhur)

Fondi per shpenzim investime (zeri 231 dhe 230) ,

1,868,000 Lekë (zeri 231) për Investime te Trupezuara. Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **723,216 Lekë** ose **38.72%**, e planit vjetor.

132,000 Lekë (zeri 230) për Investime te Trupezuara, realizimi **0%**.

Shpenzimet e domosdoshme të planifikuara dhe të miratuara gjejne realizim si blerje per programin kompjuterik financiar per nevoja te Institucionit.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile", si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

Drejtore Ekzekutive

RUDI BOBRATI